



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 177

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA SOCIALDEMOKRATE”, ME KRYETAR Z. TOM DOSHI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1260 Prot., datë 24.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike “Partia Socialdemokrate”, me Kryetar Z. Tom Doshi
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Socialdemokrate” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Socialdemokrate”, me Kryetar, Z. Tom Doshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 23.01.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Socialdemokrate”, me initiale “PSD”, me Kryetar Z. Tom Doshi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Data: 25.2.2025 Nr: 177
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Socialdemokrate” me Kryetar z. Tom Doshi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Socialdemokrate”, me shkronja nistore “PSD”, me adresë: Rruga "Skënderbej", Tiranë;
- b) Kryetar i partisë është Z. Tom Doshi, me adresë: Rruga "Skënderbej", Tiranë.
- c) Financieri i partisë është Zj. Anduela Caca, me adresë: Rruga "Skënderbej", Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Altin Vrioni, me adresë: Rruga "Skënderbej", Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Socialdemokrate”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Socialdemokrate” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Socialdemokrate”, me Kryetar Z. Tom Doshi, me shkronjat nistore “PSD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI